



NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e enjte, në datën 10 dhjetor 2020, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Gentian	SALA	Kryetar
Sami	NEZAJ	Zëvendëskryetar
Agron	GJEKMARKAJ	Anëtar
Gledis	GJIPALI	Anëtar
Suela	MUSTA	Anëtar

AMA, pasi shqyrtoi çështjet e rendit të ditës, vendosi:

1. Zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Radio Logos” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Logos” në “Bashkitë Elbasan, Cërrik, Belsh dhe Gramsh”. **(Vendimi nr. 140, datë 10.12.2020)**
2. Përcaktimin e frekuencave për shërbimin e transmetimit audio analoge dhe çeljen e garës për dhënien e licencës të transmetimit audio analoge në qarkun Gjirokastrë. **(Vendimi nr. 141, datë 10.12.2020)**
3. Dhënien e autorizimit, shoqërisë “TV Klan” sh.a., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve, online, të mbështetur në internet (OTT) “Klani IM”. **(Vendimi nr. 142, datë 10.12.2020)**
4. Dhënien e autorizimit, shoqërisë “Korabi-Net” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor “Korabi Net” në bashkinë Dibër. **(Vendimi nr. 143, datë 10.12.2020)**
5. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “Netsyscom” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “Tv Kabllor Puka”, si dhe ndryshimin e emrit të subjektit nga “Tv Kabllor Puka” në “NetSysCom TV”, në Njësinë administrative Lezhë. **(Vendimi nr. 144, datë 10.12.2020)**
6. Zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit të shoqërisë “ITCOM” sh.p.k., autorizuar për subjektin kabllor “Tv Kabllor Icom” në qarkun Shkodër. **(Vendimi nr. 145, datë 10.12.2020)**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 10 dhjetor 2020